



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 774/5 Prot.

Pogradec, më 18.02. 2025

Lënda : Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZNJ. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar Znj. Kryetare ,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues , :
**“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE
DIASPORËN 2025-2030 TË BASHKISË POGRADEC”.**

Me respekt,
KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr.i faqeve A4 të projekt-vendimit : 1

Nr.i faqeve A4 të relacionit shoqërues : 2

Nr. i fletëve të dokumentave që shoqërojnë projekt-vendimin : 92



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____, _____, 2025

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____, Datë _____, _____ 2025

PËR

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE
DIASPORËN 2025-2030 PËR BASHKINË POGRADEC”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të “ Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 36 dhe 37 të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit 16/2018 “Për Diasporën”, i ndryshuar, Ligjit 113/2020 “Për shtetësinë” i ndryshuar, Ligjit nr. 79/2021 “Për të Huajt”, Ligjit nr.7939, datë 25.5.1995 “Për Migracionin”, i ndryshuar, VKM nr. 152, datë 13.3.2024 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”, VKB nr. 152, datë 28.12.2023 “Për miratimin e Planit të Mbrojtjes Sociale 2024-2027 për Bashkinë Pogradec”, si dhe relacionit të administratës së Bashkisë Pogradec,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën të Bashkisë Pogradec për periudhën 2025-2030, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

**KRYETAR
Manjola KAMOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Pogradec, më ____ . ____ . 2025

RELACION

Në lidhje me Projekt-vendimin për miratimin e Planit Vendor i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën të Bashkisë Pogradec për periudhën 2025-2030.

Akt administrativ kolektiv

I nderuar Kryetar i Këshillit !
Të nderuar Këshilltarë!

Drejtoria e Shërbimit Social, me asistencën e GIZ Albania ka përgatitur Planin e Vendor i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën për vitet 2025-2030 për Bashkinë Pogradec. Migracioni dhe diaspora kanë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në Bashkinë e Pogradecit. Ky plan synon të integrojë këto aspekte në politikat dhe strategjitë vendore duke ofruar një platformë bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm midis komunitetit lokal dhe diasporës së Pogradecit.

Ky plan synon, gjithashtu, riintegrimin e emigrantëve që kthehen, nxitjen e investimeve të diasporës dhe krijimin e mekanizmave për përfshirjen e tyre në vendimarrje dhe zhvillimin e projekteve lokale.

Proçesi i hartimit të planit është bazuar në Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2024-2030, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2022-2030, Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit 2021-2025, Strategjia Kombëtare e Punësimit 2023-2030, Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen vendore 2023-2030, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.

Qëllimi kryesor:

Të ndërtojë një infrastrukturë të përshtatshme për të menaxhuar me efikasitet dhe koordinuar çështjeve të migracionit dhe diasporës, duke i bërë ata faktorë të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik lokal.

Fushat e përcaktuara

- 1. Organizimi dhe koordinimi institucional i diasporës dhe migracionit në nivel vendor.**



Objektivat:

- Përmirësimi i organizimit dhe funksionimit të strukturave vendore në menaxhimin e diasporës dhe migracionit
- Trajnimi i vazhdueshëm dhe rritja e aftësive të specialistëve në njësitë vendore që trajtojnë çështjet e migracionit dhe diasporës
- Ndërtimi i partneriteteve afatgjata me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e kthyer

2. Shërbimet sociale publike me bazë komunitare

Objektivat:

- Edukimi dhe informimi i qëndrueshëm në lidhje me të drejtat dhe detyrimet ligjore
- Sigurimi i shërbimeve sociale për përfshirjen dhe riintegrimin e migrantëve të kthyer dhe komuniteteve të diasporës

3. Zhvillimi dhe rritja e potencialit ekonomik të komunitetit lokal

Objektivat:

- Njohja dhe shpërndarja e nevojave vendore të komunitetit me diasporën dhe migrantët
- Sigurimi i ndihmës për të përmirësuar investimet publike dhe private nga komuniteti i diasporës

Prandaj, kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij plani si një mundësi e mirë për të realizuar objektivat e sipërhënuara dhe prioritetet e Bashkisë në lidhje me Migracionin dhe Diasporën.

Ju Faleminderit!

Konceptoi: Ivana Capollari

Miratoi: Entela Gusho

Konfirmoi: Dritan Babasuli

**KRYETAR
Ilir XHAKOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot

Pogradec, më ____, ____, 2025

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN
PËR

“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE
DIASPORËN 2025-2030 PËR BASHKINË POGRADEC”,

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, “Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të



miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon: "*Akt normativ nënligjor*" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij".

Neni 3 pika 1 shkronja "a" e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për l. "Akti administrativ":

a) "Akti administrativ individual" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) "Akti administrativ kolektiv" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij Projekt - vendimi, gjykojmë se ai është një akt i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij si dhe me miratimin do të ketë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në Bashkinë e Pogradeci i cili synon të integrojë këto aspekte në politikat dhe strategjitë vendore duke ofruar një platformë bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm midis komunitetit lokal dhe të diasporës së Pogradecit.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik: K.TANE

KRYETAR


Ilir XHAKOLLI



Implemented by **giz** German Development Cooperation



Bashkia Pogradec



Diaspora Shqiptare në botë (2020)

**PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE
DIASPORËN 2025-2030**

BASHKIA POGRADEC



PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2025-2030

BASHKIA POGRADEC

Planit Vendor i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2030 me mbështetjen e Programit "Formimi i Migrimit të Orientuar drejt Zhvillimit", i financuar nga Qeveria Gjermane dhe i zbatuar nga GIZ-Shqipëri.

Në procesin e hartimit dhe konsultimit të Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën u anagzhua grupi i punës si më poshtë,

Grupi i punës

- | | |
|--------------------|-----------------------|
| 1. Entela Gusho | Bashkia Pogradec |
| 2. Ivana Capollari | Bashkia Pogradec |
| 3. Elda Pengu | Bashkia Pogradec |
| 4. Klea Agolli | Bashkia Pogradec |
| 5. Valmira Guzi | Ekspert – Key Adviser |
| 6. Arbi Basho | Ekspert – Key Adviser |
| 7. Mariel Hysa | Ekspert – Key Adviser |

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE.....	II
LISTA E TABELAVE.....	III
HYRJE	1
METODOLOGJIA	2
KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR DHE KOMBETAR	5
PLANET VENDORE TË BASHKISË POGRADEC	12
PROFILI I BASHKISË POGRADEC	14
PERSPEKTIVA GJINORE.....	16
ANALIZA PESTEL.....	19
OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR POGRADEC	28
FUSHA E VEPRIMIT A.....	29
FUSHA E VEPRIMIT B.....	33
FUSHA E VEPRIMIT C.....	36
MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT.....	38
FORMATET E RAPORTIMIT	50

LISTA E SHKURTIMEVE

ADISA Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara

AIDA Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

AKD Agjencia Kombëtare e Diasporës

AKPA Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

AMVV Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

ASPA Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

BF Bashkia Pogradec

DAP Departamenti i Administratës Publike

DHBD Dhoma e Biznesit të Diasporës

DKM Departamenti i Kufirit dhe i Migracionit

GCM Kompakti Global për Migracionin

GIZ Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar

MB	Ministria e Brendshme
MPV	Ministri për Pushtetin Vendor
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
SDG	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SM	Sportel Migracioni
SMD	Struktura e Migracionit dhe Diasporës

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Analiza PESTEL	19
Tabela 2: Objektivat e Planit Vendor Pogradec	28
Tabela 3: Fusha e Veprimit A	31
Tabela 4: Fusha e Veprimit B.....	34
Tabela 5: Fusha e Veprimit C.....	37
Tabela 6: Monitorimi i Planit të Veprimit.....	39
Tabela 7: Formati i Raportimit të Planit të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2030, Bashkia Pogradec.....	51

HYRJE

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën në Bashkinë Pogradec u realizua në kuadër të Programit të GIZ “Fuqizimi I Politikave për orientimin e Migraionit drejt Zhvillimit”, i mbështetur financiarisht nga Qeveria Gjermane. Ky plan është bazuar në legjislacionin kombëtar kuadër, si dhe në udhëzimet për planifikimin e territorit të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Ndryshimet e ndodhura në ligjin për vetëqeverisjen vendore në vitin 2015 dhe në vitin 2019, adresojnë nevojën për hartimin e këtij plani duke përcaktuar dhe shtuar detyrat dhe funksionet e bashkive në lidhje me diasporën dhe migracionin, nëpërmjet thellimit të përgjegjësive të pushtetit lokal për këto çështje. Më Konkretisht Bashkia ka detyrat si më poshtë:

- a) Krijimi i një strukture të specializuar për menaxhimin e shërbimeve të diasporës dhe migracionit në nivel lokal, si pjesë e administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- b) Inkurajimi i organizatave brenda dhe jashtë vendit për të ruajtur komunikimin dhe forcimin e lidhjeve me diasporën dhe emigrantët shqiptarë;
- c) Ofrimi i ndihmës dhe informacionit për procesin e fitimit të shtetësisë shqiptare;
- d) Furnizimi me ndihmë dhe informacion për interesantët nga diaspora dhe migracioni rreth legjislacionit shqiptar për investimet, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për investimet;
- e) Koordinimi me ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme, të jashtme dhe për diasporën për sigurimin e ndihmës dhe informacionit për çështjet lidhur me diasporën dhe migracionin.

Nëpërmjet këtyre masave dhe politikave, synohet të krijohen struktura funksionale dhe politika të përshtatshme për menaxhimin e migracionit dhe statusit të diasporës shqiptare në botë, duke thelluar ndërveprimin e tyre në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Kjo synon dhe përfshirjen e diasporës në procesin e planifikimit të nivelit lokal dhe hartimin e një manuali me objektiva dhe masa strategjike për këtë qëllim, duke përcaktuar rolin e aktorëve të interesuar në fushën e migracionit dhe diasporës.

METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën në Bashkinë Pogradec është ndërtuar mbi parime gjithëpërfshirëse dhe të mirëkoordinuara, duke përfshirë disa faza kryesore që synojnë të adresojnë në mënyrë efektive sfidat dhe mundësitë në fushën e migracionit dhe diasporës.



Këto faza janë:

- A.** Analiza e nevojave dhe potencialit të komunitet për të identifikuar sfidat dhe mundësitë që kanë lidhje me migracionin dhe diasporën, si dhe të përcaktohen nevojat specifike të Bashkisë Pogradec nëpërmjet:
- B.** Mbledhja e të dhënave: Analizë përmes anketave, intervistave dhe konsultimeve me banorët e Pogradecit, migrantët dhe anëtarët e diasporës.
- C.** Rishikimi i dokumenteve ekzistuese: Analiza e dokumenteve dhe politikave vendore dhe kombëtare për të kuptuar situatën aktuale të migracionit.
- D.** Analiza e praktikave më të mira: Përdorimi i shembujve ndërkombëtarë dhe kombëtarë, duke përfshirë përvojën e Kosovës për kthimin dhe riintegrimin e migrantëve.
- E.** Angazhimi i aktorëve lokale dhe diasporës një proces konsultativ me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara, për të përfshirë aktorët kyç në hartimin e planit.

Nëpërmjet tryezave të rumbullakëta dhe takime me përfaqësues të bashkisë, komunitetit, bizneset lokale dhe diasporën. Krijimi i kanaleve të komunikimit për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të diasporës në zhvillimin e Pogradecit.

Zhvillimi i Kuadrit Ligjor dhe Strategjik për të të siguroar përputhshmërinë e planit me kuadrin kombëtar dhe ndërkombëtar ligjor dhe strategjik për migracionin dhe diasporën nëpërmjet

Rishikimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare: Përshtatja e këtyre politikave në

nivel lokal për të zhvilluar një plan të qëndrueshëm.

Identifikimi i detyrimeve ligjore: Reflektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, duke përshtatur këto elemente në politikat lokale.

Zhvillimi i objektivave të qarta dhe të matshme për të arritur rezultate të prekshme nëpërmjet:

Definimi i objektivave: Vendosja e objektivave për kthimin e migrantëve, përfshirjen e diasporës në zhvillimin e bashkisë dhe forcimin e kapaciteteve lokale.

Zhvillimi i një plani të veprimit: Përcaktimi i aktiviteteve specifike dhe përgjegjësi për zbatimin e planit, duke përfshirë palët lokale dhe kombëtare.

Zhvillimi i kapaciteteve të stafëve lokale për të siguruar një zbatim efektiv të planit përmes forcimit të kapaciteteve lokale konkretisht nëpërmjet:

Trajnimeve për zyrtarët lokalë: Sesione trajnimi për stafin e bashkisë në lidhje me migracionin, diasporën, dhe zhvillimin ekonomik.



Angazhimi i grupeve të punës lokale: Formimi i grupeve të punës që do të monitorojnë dhe drejtojnë zbatimin e planit në bashkëpunim me aktorët lokalë.

Monitorimi dhe Vlerësimi garantojnë që plani është duke u zbatuar sipas parashikimeve dhe nevojave të komunitetit. Për të arritur këtë është e nevojshme vendosja e indikatorëve të

matshëm për monitorimin e progresit dhe vlerësimin e sukseseve si dhe hartimi i raporteve mbi progresin dhe rekomandime për përmirësim të vazhdueshëm.

Metodat e përdorura:

Krijimi i një grupi pune të dedikuar për hartimin dhe konsultimin e planit, me përbërje nga specialist të migracionit dhe diasporës, specialist për çështjet juridike dhe specialist të kostimit dhe buxhetit në nivel bashkie me qëllim të sigurimit të një planifikimi të përmbajtjes së planit, të përshtatshëm me nevojat specifike të komunitetit lokal.



Krijimi i fokus grupe në nivel vendor, diskutime dhe mbledhja e informacionit në fokus grupe nga institucionet publike në nivel vendor për të dakortësuar fushat e veprimit, objektivat dhe masat konkrete të parashikuara.

Dialogu Shumë-Palësh i organizuar nga Key Adviser dhe GIZ (MEG) u fokusua në mbështetjen e Bashkive për zhvillimin e

Planeve Lokale të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën. Përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor, Bashkitë, AKPA, dhe sektori privat ishin të pranishëm në këtë aktivitet shumëdimensional. Key Adviser mbështeti konkretisht Bashkinë Pogradec në këtë proces për hapat e parë në hartimin e planit lokal të migracionit dhe diasporës.

Workshop dhe Trajnime:

Objekti kryesor i këtyre workshop-ve ishte shqyrtimi dhe përmirësimi i planeve draft për Bashkinë Pogradec, me fokus në forcimin e masave konkrete sipas kontekstit lokal për angazhimin e migracionit dhe diasporës si dhe për të rritur bashkëpunimin mes ekipit të ekspertëve dhe grupit të punës.

Po ashtu organizimi i sesioneve të trajnimit për përfaqësuesit lokalë të Bashkisë Pogradec ka si qëllim përmirësimin e aftësive, rritjen e kapaciteteve dhe njohurive të tyre në lidhje me hartimin dhe zbatimin efektiv të objektivave të planifikuara. Këto aktivitete janë të domosdoshme për të siguruar një qasje të koordinuar dhe të qëndrueshme në menaxhimin e burimeve dhe në arritjen e rezultateve të dëshiruara.

Gjithashtu konsultimi i Planit Vendor të Veprimit me bashkitë e tjera si Shkodra, Kukësi, Dibra, Elbasani, Korça, të cilat janë pilotuar në vitin 2021 për hartimin e Planeve Vendore për migracionin dhe diasporën.

Në fund, është ndjekur procedura e konsultimit publik i Planit Vendor të Veprimit për migracionin dhe diasporën për të siguruar pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në procesin e hartimit të planit.

KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR DHE KOMBETAR

Në spektrin ndërkombëtar Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në fushën e migracionit duke adoptuar **Marrëveshjen Globale për Migracionin (GCM)** në dhjetor 2018, gjatë Konventës Ndërqeveritare në Marrakesh, e cila synon të lehtësojë lëvizjen e sigurt të migrantëve dhe të maksimizojë përfitimet që ata sjellin. Qeveria shqiptare ka integruar GCM-në në politikat e saj të migracionit dhe ka dorëzuar një raport vlerësimi për periudhën 2019-2021, po ashtu ka hartuar raporte për rishikimin rajonal dhe kombëtar të GCM-së në vitet 2020 dhe 2022, duke e vlerësuar anëtarësimin në Bashkimin Evropian si një prioritet kyç për zhvillimin e vendit.

Përmes **Strategjisë Kombëtare për Migracionin (SKM)** dhe Planit të Veprimit 2024-2030, Shqipëria synon të përmirësojë koherencën ndërmjet politikave dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm, shtuar faktin që Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ofron udhëzime të vazhdueshme për zbatimin e GCM-së, duke nënvizuar lidhjen me SKM-në. Në këtë kontekst, një nga sfidat kryesore vazhdon të mbetet promovimi i kthimit vullnetar të migrantëve, që konsiderohet një mënyrë efektive për të parandaluar migrimin e të kualifikuarve. Kthimi dhe riintegrimi i të miturve të pashoqëruar dhe të kthyerve në rethana të cenueshme janë gjithashtu detyra të rëndësishme, me qëllim për të parandaluar keqpërdorimin e regjimit pa viza dhe për të ulur kërkesat për azil në Bashkimin Evropian, janë të nevojshme masa urgjente dhe konkrete. Një prioritet tjetër është përmirësimi i infrastrukturës për menaxhimin e flukseve të migracionit, duke krijuar hapësira adekuate për të miturit, azilkërkuarit dhe viktimat e trafikimit ku Ministria e Brendshme, përmes Drejtorisë së Politikave të Migracionit dhe Antitrafikut, është e angazhuar për të informuar vazhdimisht institucionet dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm. Për të përmirësuar zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit (2024-2030), është e rëndësishme që të krijohen mekanizma efektivë për konsultime të rregullta me palët e interesuara. Këto konsultime do të ndihmojnë në identifikimin e nevojave dhe sfidave që hasin ata që kërkojnë strehim dhe mbështetje, duke u siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret parasysh në procesin e vendimmarrjes.

Duke u mbështetur në parimet e **Kompaktit Global për Refugjatët**, Shqipëria duhet të angazhohet për të forcuar bashkëpunimin me vendet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare, për të siguruar një ndarje të drejtë të barrës dhe përgjegjësisë në trajtimin e krizave të migracionit. Iniciativat për rritjen e kapaciteteve të institucioneve përkatëse dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për refugjatët dhe migrantët do të jenë thelbësore. Kjo do të përfshijë trajnimet për punonjësit e shërbimeve sociale, ofrimin e mbështetjes psikologjike dhe sociale,

si dhe integrimin e refugjatëve në komunitetet lokale. Angazhimi i Shqipërisë në Forumin e Parë Global të Refugjatëve në 2019, dhe përfshirja e vazhdueshme për të adresuar sfidat e migracionit, tregojnë se vendi është në rrugën e duhur për të ndihmuar ata që janë në nevojë dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre. Me një qasje të koordinuar dhe proaktive, Shqipëria mund të shërbejë si një model në menaxhimin e migracionit dhe mbështetje të refugjatëve në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar.

Në përgjigje të kësaj në shkurt të 2021, qeveria shqiptare miratoi një **ligj të ri për azilin**, i cili shënon një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të sistemit të azilit me standardet ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian. Ky ligj parashikon zhvillimin e një mekanizmi nga Ministria e Brendshme për vlerësimin e proceseve të azilit dhe përmirësimin e cilësisë së procedurave, duke bashkëpunuar ngushtë me UNHCR. Një aspekt kyç i këtij procesi është organizimi i trajnimeve për zyrtarët e azilit në bashkëpunim me EUAA, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit në trajtimin e kërkesave për azil. Për më tepër, strategjia e Bashkimit Evropian për Kthimin Vullnetar dhe Riintegrimin, e publikuar në prill 2021, thekson rëndësinë e krijimit të një sistemi të përbashkët për menaxhimin e kthimeve dhe riintegrimi vullnetar të migrantëve. Kjo strategji fokusohet në forcimin e shërbimeve publike në vendet e origjinës, përfshirë kujdesin shëndetësor dhe mundësitë për punësim, duke e bërë riintegrimin më të suksesshëm. Bashkëpunimi ndërkombëtar, angazhimi i shoqërisë civile dhe përfshirja e sektorit privat janë thelbësore për arritjen e këtyre objektivave. Agjencia Frontex po ashtu është angazhuar të mbështesë këtë proces, duke dërguar oficerë ndërlidhës në vendet e treta për të organizuar ripranimin e migrantëve dhe për të ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve vendore.

Qeveria shqiptare ka shprehur angazhimin e saj për të harmonizuar politikat kombëtare me ato të BE-së përmes **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030**. Kjo strategji përfshin prioritetet për migracionin që përputhen me paktin e BE-së, me një fokus të veçantë në tërheqjen e migrantëve shqiptarë dhe lehtësimin e riintegrit të tyre. Gjatë Samitit të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, u diskutua gjithashtu për Planin e Veprimit të BE-së, i cili përmban 20 masa operationale për forcimin e menaxhimit të kufijve, procedurat e shpejta të azilit dhe luftimin e kontrabandës së migrantëve. Qeveria shqiptare ka integruar këto masa në Strategjinë Kombëtare të Migracionit dhe Planin e Veprimit 2024-2030, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për menaxhimin e migracionit të sigurt dhe të rregullt.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë në vitin 2023 konfirmon se kuadri ligjor për

migracionin është gjerësisht në përputhje me acquis të BE-së, duke dëshmuar angazhimin e vendit për të përmirësuar sistemin e tij të menaxhimit të migracionit dhe për të siguruar një mbështetje efektive për ata që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Këto nisma përfaqësojnë një hap të rëndësishëm përpara në rrugën e Shqipërisë drejt integrimit në Bashkimin Evropian dhe ofrojnë një perspektivë më të mirë për migrantët dhe ata që kërkojnë azil. Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe BE-së për zbatimin e **Planit të Veprimit për Ballkanin Perëndimor** ka sjellë rezultate të dukshme. Shqipëria ka finalizuar një Marrëveshje të rishikuar me Frontex-in, duke përafuar 26 nga 29 aktet legislative të nevojshme. Megjithatë, sfidat mbeten, sidomos në lidhje me kthimin e shtetasve të vendeve të treta, që është ende në nivele të ulëta. Policia e Kufirit dhe Migracionit ka nevojë të krijojë struktura trajnuese për identifikimin e grupeve vulnerabël dhe të forcojë koordinimin me departamentet e antitrafikut dhe mbrojtjes së fëmijëve. Në fushën e azilit, Shqipëria ka përafuar 15 akte legislative, por konsultimet me EUAA vazhdojnë të mbeten thelbësore për përmirësimin e procesit. Rritja e kërkesave për azil nga shqiptarët në vendet e BE-së tregon nevojën për masa ri-integrimi, veçanërisht për ata që janë më në nevojë. Raporti gjithashtu evidenton progresin në lirinë e lëvizjes, me një rënie të refuzimeve në pikat kufitare.

Në aspektin e kuadrit kombëtar janë një sërë dokumentash strategjikë që përputhen dhe përkojnë më masat dhe objektivat e planit të veprimit si, **Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit 2021-2025** që janë korniza strategjike për mbështetje ndaj shqiptarëve jashtë atdheut. Qëllimi kryesor është hartimi i politikave gjithëpërfshirëse për komunitetet shqiptare, duke siguruar angazhim dhe mbështetje ligjore. Strategjia promovon integrimin dhe kontributin e diasporës në zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë. Ajo synon të fuqizojë lidhjet mes shqiptarëve në mbarë botën dhe të ndihmojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve dhe vendit. Plani i veprimit përforcon politikën lokale për të krijuar një bashkëpunim të qëndrueshëm.

Një tjetër dokument që përkon me objektivat dhe masat e planit të veprimit është **Strategjia Kombëtare e Migracionit dhe Plani i Veprimit 2024-2030** synojnë të koordinojnë aktivitetet e institucioneve për të arritur objektivat e politikave migratore. Fokusohen në zhvillimin e politikave efektive që promovojnë ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik. Dokumenti përfshin masa për lehtësimin e procedurave për leje unike, shërbime integrimi dhe riintegrim të emigrantëve. Rëndësi i jepet krijimit të mekanizmave koordinues në të gjitha nivelet e qeverisjes, sidomos në nivelin lokal.

Zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse është thelbësor për maksimizimin e përfitimeve nga migracioni dhe ndikimin e qëndrueshëm në ekonomi, sakaq **Strategjia Kombëtare e Punësimit 2023-2030** në Shqipëri adreson sfidat e punësimit përmes pesë qëllimeve kryesore si : reduktimi i mospërputhjeve të aftësive, rritja e niveleve të aftësive për të dyja gjinitë, përmirësimi i vlerave të punës, dixhitalizimi i mbështetjes për punësim dhe sigurimi i funksionimit të saktë dhe në kohë të masave. Ajo gjithashtu fokusohet në integrimin social dhe territorial, duke adresuar sfidat e migracionit dhe diasporës me një qasje të personalizuar. Kjo strategji ofron një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për të krijuar mundësi të reja punësimi dhe zhvillimi në Shqipëri.

Një dokument tjetër që korespondon me qëllimet dhe masat e planit të veprimit është **Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021-2027** që thekson rëndësinë e diasporës shqiptare për rritjen ekonomike të vendit. Ajo nxit angazhimin e diasporës në aktivitete ekonomike dhe promovon nisma sipërmarrëse, duke krijuar një kuadër ligjor që lehtëson investimet. Qëllimi është forcimi i lidhjeve brenda komunitetit shqiptar dhe shfrytëzimi i potencialit të diasporës si burim për zhvillimin ekonomik. Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën synon krijimin e një ambienti miqësor për bashkëpunim dhe përmbushjen e nevojave lokale për investime nga diaspora.

Arsimi në Republikën e Shqipërisë menaxhohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas **Strategjisë Kombëtare për Arsimin dhe Planit të Veprimit 2021-2026**. Këto dokumente adresojnë sfidat e arsimit duke përcaktuar përgjegjësitë midis Ministrisë së Arsimit dhe njësive lokale të vetëqeverisjes vendore. Ato kanë rol të rëndësishëm në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore, veçanërisht në sistemin e arsimit parashkollor. Strategjia thekson mbështetje për fëmijët në rrezik, duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe minoritetet. Po ashtu, në kuadër të planit për Migracionin dhe Diasporën, fokusohet në ofrimin e informacionit dhe mbështetje për rikthyerit dhe të huajt, për të lehtësuar integrimin e tyre në shoqëri. Një tjetër shërbim thelbësor që ofrohet në njësitë e vetëqeverisjes vendore është shërbimi shëndetësor.

Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030 synon të sigurojë zbatimin efektiv të nismave shëndetësore në nivel kombëtar përmes një bashkëpunimi të ngushtë me aktorë të ndryshëm, si ministritë dhe përfaqësuesit vendor. Kjo strategji ofron një kornizë të qartë për koordinimin dhe mbështetje për ata që përballen me sfida të veçanta, siç janë ata që rikthehen nga emigracioni dhe të huajt. Ajo garanton akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor në nivel

lokal, duke siguruar që çdo individ të ketë mundësi për të përfituar nga shërbimet e nevojshme. Në këtë mënyrë, strategjia kontribuon në një mirëqenie më të plotë të popullsisë, duke adresuar nevojat unike të grupeve të ndryshme dhe duke krijuar një sistem shëndetësor më të integruar dhe të aksesueshëm për të gjithë përfshirë të huajt që jetojnë në Shqipëri.

Ndërkohe një aspekt tjetër më largpamës thekson rëndësinë që ka **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2022-2030** në Shqipëri paraqet një qasje gjithëpërfshirëse, e cila ndërtohet mbi sukseset e strategjisë së mëparshme (2015-2020). Ajo fokusohet në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe aspiratave për anëtarësim në Bashkimin Europian. Kjo strategji angazhon institucione të ndryshme, duke siguruar një koordinim të efektshëm në procesin e zhvillimit dhe integritit të vendit. Gjithashtu, Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën synon të krijojë një sistem të fuqishëm qeverisjeje për menaxhimin e migracionit, duke adresuar sfidat përkatëse dhe duke theksuar rëndësinë e tij për zhvillimin kombëtar.

Pa dyshim, që rinia është e ardhmja e çdo kombi, dhe **Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029** synon të fuqizojë të rinjtë në Shqipëri, duke i inkurajuar ata të angazhohen aktivisht në shoqëri dhe në proceset vendimmarrëse. Kjo strategji përfshin politika të informuara dhe të mirëfinancuara, të cilat promovojnë mundësi arsimore dhe zhvillimin e aftësive në një kontekst global. Një fokus i veçantë i saj është adresimi i nevojave të grupeve vulnerabël, si studentët e huaj dhe ata që janë kthyer nga emigracioni. Qëllimi është të krijohet një kuadër gjithëpërfshirës që siguron zhvillimin dhe mirëqenien e të rinjve, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre aktive dhe integrimin në tregun e punës. Kjo do të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie më të fortë dhe më të qëndrueshme, ku çdo i ri ndjen se ka një rol të rëndësishëm në formësimin e të ardhmes së vendit të tij.

Një rëndësi të padiskutueshme ka **Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030** e cila paraqet një bazë të fortë për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe ofrimin e shërbimeve më afër qytetarëve duke theksuar rëndësinë e njësisive të vetëqeverisjes vendore në sigurimin e qeverisjes së mirë, duke përmirësuar shërbimet për komunitetet. Reforma administrative ka sjellë decentralizim të funksioneve, duke i lejuar bashkive të operojnë në mënyrë demokratike dhe të adresojnë nevojat specifike të komuniteteve të tyre. Qëllimi kryesor i strategjisë është konsolidimi i procesit të decentralizimit, me fokus në zhvillimin ekonomik lokal të qëndrueshëm, duke ofruar shërbime cilësore dhe transparente. Përmes rritjes së kapaciteteve për menaxhimin e aseteve,

digjitalizimit të shërbimeve dhe forcimit të autonomisë financiare, strategjia synon të përmirësojë efikasitetin e qeverisjes vendore. Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën gjithashtu përfshin masa për të siguruar akses më të mirë në shërbime për grupet e cënueshme, duke integruar aspektet e migracionit në zhvillimin lokal, për të garantuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Një tjetër dokument është **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030** synon zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e jetesës për individët në nevojë, përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe grupe vulnerabël. Ajo promovon skema financiare të qëndrueshme për fuqizimin dhe integrimin e këtyre individëve përfshirë të huajtë. Strategjia fokusohet në qasjen e barabartë në shërbime sociale dhe zhvillimin e aftësive për integrim në tregun e punës. Masa konkrete mbështesin riintegrimin social-ekonomik, duke lidhur punësimin me promovimin e ndërmarreve sociale dhe janë në harmoni me planin për Migracionin dhe Diasporën.

Një rëndësi të vecantë, për vetë faktin se integrimi gjinor vazhdon të mbetet një çështje e rrejte dhe e diskutueshme, paraqet dhe **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030** që është një iniciativë kyçe për promovimin e të drejtave të grave dhe reduktimin e diskriminimit gjinor. E hartuar në bashkëpunim me institucione të ndryshme, ajo fokusohet në garantimin e të drejtave ekonomike dhe sociale për të gjitha grupet, pa dallim gjinie. Strategjia inkurajon trajtimin e barabartë në shërbime dhe aksesin në teknologji, duke siguruar mundësi të barabarta për zhvillim ekonomik. Në kuadër të planit të veprimit për Migracionin dhe Diasporën, theksohet rëndësia e barazisë gjinore për fuqizimin e grave dhe vajzave, duke krijuar një ambient të drejtë për të gjithë individët në shoqëri.

Një aspekt tjetër që lidhet prek drejtpërdrejt nivelin lokal është dhe **ligji për Vetëqeverisjen Vendore nr. 139/2015**, së bashku me ndryshimet e **ligjit nr. 38/2019**, ka sjellë një transformim të rëndësishëm në organizimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, duke u fokusuar në decentralizimin dhe efikasitetin e administratës publike. Një element thelbësor është angazhimi me diasporën dhe komunitetet e migrantëve, ku bashkitë tani kanë përgjegjësi të qarta për këto grupe. Struktura të posaçme adresojnë shqetësimet e të rikthyerve dhe emigrantëve, ofrojnë asistencë dhe informacion mbi legjislacionin e investimeve, si dhe krijojnë mundësi integrimi, duke forcuar lidhjet midis shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Kjo kontribuon në forcimin e komuniteteve dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë.

Një ligj që prek drejtpërdrejt kategorinë e të huajve në Shqipëri është **"Ligji për Të Huajt" nr 79 / 2021** që është një dokument i rëndësishëm që rregullon mënyrën se si individët e huaj

hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga vendi. Ai përfshin aspekte kyçe si lëshimi i vizave dhe lejeve të qëndrimit, duke mbështetur parime themelore si interesi më i mirë i familjeve, uniteti familiar dhe nondiskriminimi. Ky ligj zbatohet për të huajt që vijnë në Shqipëri për arsye punësimi, studimi ose qëndrimi, duke përcaktuar në mënyrë të qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe ato të autoriteteve përkatëse. Me avancimin e procesit të dixhitalizimit, aplikimet për vizat dhe lejet e qëndrimit tani janë bërë më të lehtë dhe më të aksesueshme, pasi mund të realizohen online. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ata që hasin vështirësi për shkak të mungesës së misioneve diplomatike në disa vende. Gjithashtu, ligji përfshin masa për integritetin e migrantëve, duke ofruar shërbime dhe programe arsimore që ndihmojnë ata në orientimin në sistemin institucional shqiptar. Kjo qasje e integruar jo vetëm që përmirëson aksesin në shërbime thelbësore, por gjithashtu oxit një integrim të suksesshëm të të huajve në shoqërinë shqiptare. Duke siguruar mbështetje dhe hirime, ligji respekton të drejtat e njeriut dhe kontribuon në krijimin e një ambienti më miqprithës për të gjithë ata që zgjedhin Shqipërinë si vend të tyre të ri.

Duke u mbështetur në njohuritë e marra nga shtyllat e mëparshme, shtylla e tretë fokusohet në zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës objektivash dhe masash konkrete. Kjo përfshin sintetizimin e gjetjeve nga analiza e nevojave dhe ekzaminimi i kuadrit ligjor dhe strategjik për të të formuar objektivat konkrete dhe masa të zbatueshme. Në këtë mënyrë duke përcaktuar objektivat të qarta dhe masa, synohet të sigurohet një udhërrëfyes për adresimin e nevojave të identifikuara dhe shfrytëzimin efektiv të potencialit të grupit të synuar për zhvillimin socio-ekonomik. Përmes analizës së kontekstit dhe vizitave në terren, është krijuar një përmbledhje e situatës dhe gjendjes faktike në këtë Bashki. Hartimi dhe konsultimi i Planeve Lokale është realizuar përmes përpjekje bashkëpunuese me grupin punës për të hartuar një dokument sa më të qartë dhe të zbatueshëm. Këto plane përfshijnë objektivat të matshëm, aktivitetet konkrete dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara.

PLANET VENDORE TË BASHKISË POGRADEC

Bashkia Pogradec ka një kalendar vjetor në ndihmë të komunitetit të Pogradecit për të organizuar në mënyrë strategjike një sërë aktiviteteve kulturore gjatë gjithë vitit për të promovuar angazhimin e komunitetit dhe për të festuar traditat lokale. Megjithatë ka patur iniciativa për të nxitur ndjenjën e përkatësisë dhe krenarisë tek banorët ndërsa duke nxjerrë në pah trashëgiminë e pasur kulturore të rajonit. Bashkia ka zhvilluar vazhdimisht ngjarje kulturore, duke përfshirë ritet dhe festimet që lidhen me festat e rëndësishme dhe sezonale ndryshimet. Për shembull, festimet organizohen rreth ditëve që shënojnë ditën Botërore të Artit më 15 Prill, dita e Çeljes së Sezonit Turistik më 6 Qershor, dita e Liqenit të Ohrit më 21 Qershor dhe raste të tjera të rëndësishme kulturore. Për më tepër, për të promovuar vlerat dhe traditat por edhe për të ndarë eksperiencat e emigrantëve më 10 Gusht organizohet festa e përvitshme “Mall për Vendlindjen” në fshatin Homçan. Nëpërmjet kësaj feste të investuar nga vetë diaspora nderohen vetë emigrantët që jetojnë jashtë vendit për kontributet e tyre por edhe për ndarjen e përvojave të tyre jashtë vendit. Në këtë mënyrë Bashkia Pogradec demonstroi përkushtimin e saj për të nxitur lidhjet me komunitetin e diasporës dhe promovimin e ndjenjës së unitetit përtej kufijve gjeografikë.

Dokumenti i Planit të Mbrojtjes Sociale (PMS) i Bashkisë Pogradec 2024-2027 i shërben jo vetëm si pjesë e përfaqësues strategjike për zhvillimin e Bashkisë në tërësi, por edhe si një nevojë për një qeverisje të mirë dhe demokratike, për të përmbushur përgjegjësinë ndaj qytetarëve për shërbime sociale të përshtatshme. Ky dokument është baza mbi të cilën mbështeten iniciativat e Bashkisë, shoqërisë civile, dhe ofruesve publik dhe privat të shërbimeve sociale, për zgjidhjen e problemeve sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë. **Plani Mbrojtjes Sociale** është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

Në këtë bashki Plani i Mbrojtjes Sociale adreson të gjithë problematikat për grupet vunerabël dhe në këtë prizëm mund të adresohen edhe problematikat që përfshijnë nevojat e migrantëve të kthyer dhe të mundshëm. Në zbatim të vizionit dhe politikave për mbështetjen e qytetarëve, Plani i Mbrojtjes Sociale Bashkia Pogradec 2024 – 2027 përfshin masat që synojnë adresimin e problemeve, si më poshtë:

A. Zhvillimi dhe ofrimi i programeve sociale parandaluese

Kjo masë fokusohet në rritjen e niveli i ndërgjegjësimit të grupeve të rrezikuara rreth temave që shqetësojnë komunitetin për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe garantimin e shërbimeve cilësore dhe eficiente, sa më afër qytetarëve.

B. Të ofrohen programe edukuese për fuqizimin e familjes

Duke qenë se emigrimi i kryefamiljarëve ka vendosur familjen dhe antarët e saj përpara sfidave të ndryshme, organizimi i aktiviteteve edukuese mbi prindërimin, ndarjen e roleve gjinore në familje, dhe mirërritjen e fëmijëve synojnë forcimin e marrëdhënies midis partnerëve dhe zvogëlimin e problematikave për mbivendosjen e roleve dhe raportin me fëmijët.

C. Zbutja e papunësisë përmes ofrimit të kurseve profesionale, të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me nevojat locale

Nëpërmjet kësaj mase synohet të kualifikohen personat e papunë përmes pjesëmarrjes në kurse profesionale në bashkëpunim me shkollën profesionale, Zyrën Vendore të Punësimit dhe OJF-ve. Edukimi profesional ndikon jo vetëm për zvogëlimin e largimit të fuqisë puntore jashtë vendit por edhe për punësimin e partnereve femra, të cilat partnerët e tyre kanë emiguar jashtë vendit.

D. Të ofrohen shërbime mbështetëse për individët dhe familjet në situatë të vështirë sociale dhe ekonomike

Mbështetja e familjeve, fëmijëve dhe të rinjve të ekspozuar ndaj migrimit për të adresuar nevojat socio-ekonomike, arsimore dhe psikosociale të individëve ndikuar nga migrimi, me fokus në nxitjen e elasticitetit dhe mirëqenies.

PROFILI I BASHKISË POGRADEC

Bashkia Pogradec shtrihet në juglindje të Shqipërisë, në anë të bregut jugperëndimor të liqenit të Ohrit (695 metra mbi nivelin e detit). Bashkia ka gjithësej një popullsi prej 91.957 banorësh dhe ka një sipërfaqe prej 548.77 km². Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Pogradecit



dhe ka nën administrim 72 fshatra, të cilat janë pjesë e 8 njësive administrative rurale përkatësisht Buçimas, Çërravë, Udënisht, Bahçallëk, Proptisht, Velçan, Dardhas dhe Trebinjë. Pogradeci kufizohet në veri me Bashkinë Prrenjas, në perëndim me Bashkinë Gramsh, në jug me Bashkinë Maliq, në juglindje me Bashkinë Pustec, ndërsa në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Pogradeci dallon për pozicionin gjeografike mjaft të favorshëm, duke shërbyer si një portë lidhëse në jug-lindje të vendit për shumë qytete.

Në Bashkinë e Pogradecit kalon rruga nacionale Tiranë – Korçë pjesë e korridorit të VIII-të, rruga e re lidhëse Qafë Thanë –

Qafë Pillocë, si dhe linja hekurudhore Pogradec – Elbasan. Në

këtë Bashki gjenden edhe dy pikat doganore me Republikën e Maqedonisë së Veriut siç janë pika kufitare e Tushemishtit dhe e

Qafë Thanës. Në territorin e Bashkisë gjenden elementë të rëndësishëm territorialë; burime natyrore si: liqeni i Ohrit, Parku i Drilonit, lumi Shkumbin, malet e Mokrës etj.

Në aspektin ekonomik, Pogradeci në të kaluarën ka qenë një qendër e rëndësishme industriale në Shqipëri. Për t'u përmendur janë industria e kromit, e hekurit, e nikelit, e qymyrit, e peshkimit, e përpunim drurit dhe të pijeve. Sot,

Liqeni i Ohrit është një pikë e rëndësishme referimi për ekonominë e qytetit të Pogradecit dhe disa fshatra që shtrihen përgjatë tij, si Udënisht, Buçimas, Lin, Tushemisht dhe Zona Turistike Drilon. Popullsia e kësaj zone orientohet kryesisht drejt ekonomisë së lidhur me turizmin, industrinë e mikpritjes, bujqësinë, blegtorinë, peshkimin dhe fermat e rritjes së peshkut.

Veç kësaj, sektori i artizanatit, i cili ofron mundësi punësimi sidomos për gratë në zonat rurale, ka hedhur hapat e parë drejt zhvillimit dhe bashkisë duke mbështetur dhe nxitur për rritjen e kapaciteteve të punësimit në këtë sektor. Zona ka shumë elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, ku vlen të theksohet klima, ajri i pastër, peizazhe piktoreske, histori të pasur,

vlera kulturore dhe gatime tradicionale përbërë nga produkte të shëndetshme si dhe potencial për zhvillim edhe më të madh në agro-turizëm.

Në Bashkinë Pogradec ka burime natyrore, site historike dhe kulturore shumë të rëndësishme, të cilat kanë vëmendje të veçantë pasi janë potencial i paqmuar për identitetin e zonës por edhe për të tërhequr turistët dhe zhvillimin e turizmit. Duke marrë në konsideratë gjetjet e vleratueshme, Fshati Lin mendohet të ketë qënë një një vendbanim i lashtë dhe i madh, ku ndodhet edhe Mozaiku i Bazilikës së Linit. Në afërsi të fshatit Bishnicë ndodhen liqenet e Lukovës, të cilat janë liqene me origjinë akullnajore dhe ndodhen në lartësi 1371 m nga niveli i detit. Në njësinë administrative Prognisht ndodhen varret monumentale të Seleës, të cilat janë monument kulturor i kategorise të parë. Ndër elementët e tjerë kryesorë kulturore dhe tërheqës për turistë mund të përmenden: Guri i Kumjes, Kalaja e Pogradecit, Manastiri dhe kisha e Shën Marenës, Btapi i Rodokalit, Parku i Drilonit, Mozaiku dhe ishtri turistik i Fushemishtit etj.



PERSPEKTIVA GJINORE

Përkatësia Gjinore në Çështjet e Migracionit dhe Diasporës

Perspektiva gjinore në çështjen e migracionit dhe diasporës përfaqëson një qasje të rëndësishme që eksploron sesi rolet tradicionale gjinore, normat kulturore dhe struktura sociale ndikojnë në përvojat dhe vendimet e individëve që migrojnë. Migracioni nuk është një përvojë uniforme; ajo ndryshon në mënyrë të theksuar sipas gjinisë, duke formuar ndryshe sfidat dhe mundësitë për burrat, gratë dhe individët me identitete gjinore të ndryshme.

Historikisht, burrat janë parë si kryesorët që marrin rolin e migrantit, duke u larguar për të kërkuar mundësi ekonomike dhe për të mbështetur financiarisht familjet e tyre. Në këtë kontekst, gratë kanë luajtur rolin e kujdestarëve të familjes, që mbeten pas në vendin e origjinës. Megjithatë, ky model ka evoluar ndjeshëm. Sot, një numër i madh i grave marrin pjesë në proceset migratore, shpesh duke u bërë kryefamiljare dhe duke përmbushur një sërë përgjegjësish që më parë mund të ishin rezervuar për burrat. Pavarësisht nga kjo rritje e pjesëmarrjes së grave në migracion, përvoja e tyre shpesh mbetet e karakterizuar nga pabarazia dhe diskriminimi.

Gratë migrante janë më të prekshme ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, abuzimeve seksuale, shfrytëzimit në tregun e punës dhe dhunës fizike e psikologjike. Në shumë raste, ato përballen me një mungesë të qasjes në shërbime shëndetësore, edukative dhe mbrojtje ligjore, kryesisht për shkak të mungesës së dokumentacionit të ligjshëm ose frikës nga abuzimeve. Nga ana tjetër, burrat përballen me presione të tjera, shpesh të ndërlidhura me pritshmëritë tradicionale që lidhen me rolin e tyre si "mbajtësit e familjes". Ata mund të përballen me sfida të rënda në tregun e punës, shpesh duke u përfshirë në sektorë me rrezik të lartë dhe paga të ulëta. Për burrat, migracioni mund të nënkuptojë edhe izolim shoqëror dhe mungesë të mbështetjes emocionale, pasi normat gjinore shpesh nuk lejojnë hapjen e tyre për ndihmë. Kur gratë migrojnë, një tjetër aspekt i rëndësishëm është roli që luajnë si faktor ndryshimi në familjet dhe komunitetet e tyre. Shpesh, ato përjetojnë transformim në strukturat gjinore, duke marrë më shumë autonomi dhe fuqi vendimmarrëse në familje dhe duke ndikuar në ndryshimin e normave tradicionale në shoqërinë e origjinës së tyre por edhe në përplasjen që mund të ndeshen për shkak se ndryshimet në një kulturë nuk janë të lehta për tu përballur.

Në diasporë, gjinia luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e përfshirjes sociale dhe ekonomike të individëve. Gratë shpesh kontribuojnë në ekonominë e vendeve pritëse në sektorë

të nënvlerësuar si puna në shtëpi, kujdesi dhe shërbimet, ndërsa burrat në sektorët e vështirë ose punët e rënda ndërtim, transport, riciklim, apo lloje të tjera punësh me kualifikim të ulët ose bazë. Megjithatë, këto punë janë shpesh të padukshme dhe të nënvlerësuar nga shoqëria pritëse. Diaspora mund të ofrojë një hapësirë për ndërtimin e solidaritetit midis grave, si edhe midis burrave, ashtu sikurse edhe midis dy gjinive me njëra-tjetrën, duke krijuar rrjete mbështetjeje për të ndihmuar njëra-tjetrën të përballen me sfidat e përditshme të jetës së migrantëve.

Në këtë kuadër, perspektiva gjinore zbulon sesi gratë dhe burrat e prekur nga migracioni përjetojnë në mënyra të ndryshme problemet dhe sfidat që lindin nga vendimi për të lëvizur. Kjo qasje e thellë dhe gjithëpërfshirëse i fton profesionistët dhe politikëtarët publikë të përqendrohen në njohjen e nevojave dhe përvojave unike të individëve, duke u bërë kështu procesin e kurtimit të politikave më të ndryshëm ndaj gjinisë. Në këtë kontekst, punonjësit socialë luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e sfidave specifike që hasin grupet e ndryshme, duke ofruar një mbështetje të personalizuar dhe duke promovuar zgjidhje që respektojnë diversitetin e përvojave njerezore. Politikat migratore gjithashtu duhet të jenë të ndryshme ndaj këtyre dinamikave, duke u siguruar që çdo individ. pavarësisht nga gjinia, të ketë akses në mbështetje dhe mbrojtje të përshtatshme. Kjo do të thotë që strategjitë e migracionit duhet të përfshijnë aspekte të ndryshme, si mbrojtja nga abuzat dhe shfrytëzimi, si dhe promovimi i integritetit dhe mundësive për zhvillim personal dhe profesional. Bashkia, si institucioni më afër me qytetarët, ka një rol kyç në procesin e integritetit dhe mbështetjes së individëve që kthehen ose migrojnë në një zonë të re. Ajo shërben si pika e parë e kontaktit për shumë njerëz që kanë nevojë për informacion rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre si qytetarë, duke ofruar shërbime dhe orientim të domosdoshëm për të kaluar nëpër procedurat administrative dhe sociale. Një plan veprimi për migracionin dhe diasporën është mëse i nevojshëm për të adresuar stevojat specifike të grupeve të ndryshëm brenda shoqërisë. Kur flasim për këtë plan, është e rëndësishme të kemi parasysh dhe perspektivën gjinore, pasi burrat dhe gratë përballen me sfida dhe mundësi të ndryshme në kontekstin e migracionit. Kjo qasje gjinore në menaxhimin e migracionit është thelbësore për të siguruar që nevojat dhe përvojat e të gjithë individëve të merren parasysh. Kjo do të thotë që bashkia duhet të angazhohet në krijimin e politikave dhe programeve që jo vetëm që mbështesin integritetin e migrantëve, por gjithashtu promovojnë barazinë gjinore. Kjo përfshin ofrimin e trajnimeve, aktiviteteve që ekzistojnë bashkëpunim dhe bashkëjetesën, si dhe informimin rreth të drejtave ligjore dhe mundësive që ekzistojnë për të dyja gjinive. Një komunitet i integruar dhe i barabartë është një

komunitet më i fortë dhe më rezistent, në të cilin çdo individ ka mundësinë për t'u zhvilluar dhe kontribuar në mënyrë të barabartë.

ANALIZA PESTEL

Analiza e mëposhtme PESTEL është zhvilluar nga grupi i ekspertëve që përgatitën Planin Vendor për Migracionin dhe Diasporën në Bashkinë Pogradec për periudhën 2025-2030. Analiza bazohet në informacionin e dhënë nga Bashkia Pogradec, kërkimet, punën studimore dhe të dhënat e gjeneruara nga diskutimet si dhe seminarët gjatë periudhës Shkurt – Maj 2024. Në këtë kontekst, të dhënat janë mundësuar në bashkëpunim me autoritetet vendore dhe stafin e Bashkisë Pogradec. Evidencat bazohen në faktorët politik, ekonomik, socio-kulturor dhe teknologjikë. Njëkohësisht, ndikimi i faktorëve specifikë në zhvillimet në Bashki u vlerësua në një shkallë me tre faza dhe parashikimi i faktorëve me vlersimin pozitiv, nuk ka ndryshim dhe negative. Më poshtë, gjendet Tabela 1 me të dhënat e gjeneruara për Bashkinë Pogradec.

Tabela 1: Analiza PESTEL

FAKTORËT	Fuqia e ndikimit në zhvillimin e bashkisë	Parashikimi i drejtimt të ndikimit të faktorëve
FAKTORËT POLITIK		
Stabiliteti Politik	3	↑
Shpërndarja strukturore e fondeve të BE	2	↑
Bashkëpunimi ndërkombëtar	1	↑
Mbështetja për zhvillimin rajonal	1	↑
Taksat Vendore	1	↑
Niveli i decentralizimit	1	↑
Rregulloret mjedisore	1	→
Kapacitetet e burimeve njerëzore në nivel vendor	3	↑
Zhvillimi i partneritetit publik privat	2	↑
FAKTORËT EKONOMIKË		
Gjendja e ekonomisë	1	↑
Dinamika e rritjes ekonomike	1	↑
Gjendja e financave publike	1	↑
Zhvillimi i industrisë së turizmit	2	↑
Tendencat ekonomike të brendshme	1	↑
Ndikimi dhe niveli i investimeve të huaja	1	↑

Vendndodhja gjeografike	3	↑
Konkurrenca nga njësitë e tjera territoriale	3	↓
Cilësia e politikës ekonomike qendrore	3	↑
Niveli mesatar i të ardhurave	1	↑
Kostot e punës	2	↑
Shkalla e papunësisë	3	↓

FAKTORËT SOCIAL-KULTURORË

Roli i burrave dhe grave në shoqëri	3	↑
Emigracioni i punëtorëve të kualifikuar	3	↓
Imigrimi i punëtorëve të pakualifikuar	3	↓
Ndërgjegjësimi ekologjik	2	↑
Pabarazitë sociale	2	↓
Zhvillimi i kapitalit njerëzor	3	↑
Lëvizshmëria e punëtorëve	3	↑
Tendencat e stilit të jetesës	3	↑
Nivelet e përgjithshme të aspiratës së njerëzve	1	↓
Zhvillimi i Organizatave Joqeveritare	3	→
Fondet për kujdesin shëndetësor dhe social	1	↑
Shkalla e rritjes së popullsisë	1	↑
Plakja e popullsisë	3	↓
Identiteti lokal	2	↑

FAKTORËT TEKNOLOGJIKË

Zhvillimi i infrastrukturës së transportit (teknik).	2	↑
Fondet për projektet e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit	1	↑
Automatizimi	2	↑
Zhvillimi i mediave sociale	3	↑
Zhvillimi i inovacionit	1	↑
Zhvillimet e fundit teknologjike	1	↑
Akses në teknologjitë moderne	2	↑
Zhvillimi i tele-çorë	2	↑

**Legjenda e Tabelës*

Poqja e ndikimit:

- ❖ 3-e lartë;
- ❖ 2-mesatare;
- ❖ 1-e ulët

Parashikimi i drejtimit:

- ❖ pozitive ↑;
- ❖ s'ka ndryshim →;
- ❖ negative ↓

Në Bashkinë Pogradec, **stabiliteti politik dhe kapacitetet e burimeve njerëzore** në nivel vendor konsiderohen dy faktorët politik me ndikimin më të madh. Stabiliteti politik parashikohet se ndikon pozitivisht në procesin e vendimarrjes si dhe rritja e kapaciteteve njerëzore rrit cilësinë e shërbimeve.

Ndër faktorët me ndikim mesatar por parashikohet rëndësi në rritje listohen shëndarja strukturore e fondeve të Bashkimit Evropian dhe zhvillimi i partneritetit public privat. Nëpërmjet tërheqjes së fondeve parashikohet ofrim shërbimesh konkrete dhe më cilësor. Po ashtu bashkëpunimi me bizneset private për politikën e migracionit dhe diasporës vlerohet si frytdhënës për të ardhmen. Vëmendje e veçantë i duhet dhënë bashkëpunimit ndërkombëtar, mbështetjes për zhvillim rajonal, taksave vendore, nivelit të decentralizimit dhe rregullores mjedisore pasi listohen ndër faktorët e zhvillimit të Bashkisë me ndikim të ulët por parashikohet efekt pozitiv sepse ndikojnë në zhvillimin e bashkisë dhe përmirësimin në një numër aspektesh siç janë rritja e fondeve për integrimi, rritjen e instrumenteve për implementimin e praktikave më të mira, taksë më të ulëta për të nxitur investimet, politika më të mira për mjedisin etj. Duhet theksuar se nuk ka patur më parë një iniciativë konkrete për riintegrimin e emigrantëve të kthyer apo kategorive të tjera.

Bashkia e Pogradecit është në hapat e para të këtyre iniciativave për shkak se është një nevojë e re që ka lindur për t'u përmirësuar. **Çështjet e migracionit dhe diasporës** janë hasur kohët e fundit në Bashkinë Pogradec dhe për rrjedhojë është e nevojshme hartimi dhe marrja e masave konkrete për menaxhimin e sfidave të migracionit dhe diasporës me efikasitet. Për më tepër Bashkia Pogradec ka bashkëpunuar me insitucionet e pavaruara për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve (Komisionerët/ Avokati i Popullit) për problematika të ndryshme por asnjëherë për çështjet të lidhura drejtpërdrejt për migrimin dhe diasporën.

Gjithashtu, Bashkia e Pogradecit ka bashkëpunuar vazhdimisht me Organizata të ndryshme lokale, kombëtare apo ndërkombëtare në shumë fusha të tjera sociale por nuk ka pasur asnjëherë projekt për migracionin dhe diasporën. Evidentohet nevoja për mbështetje nga ekspertë të huaj dhe projekte gjithëpërfshirëse për adresimin efektiv të çështjeve të migracionit

dhe diasporës. Për sa i përket bashkëpunimit me organizatat lokale, vlen të theksohet fakti se janë të specializuara në fusha sociale të ndryshme por nuk janë të specializuara për të dhënë shërbime në fushën e migracionit dhe diasporës. Disa nga organizatat lokale që Bashkia ka bashkëpunuar janë Unë Gruaja; Gruaja Intelektuale, Nehemia, Drita e Shpresës, Diakonia etj. Si dhe disa prej organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që Bashkia Pogradec ka bashkëpunuar janë UNDP, UN WOMEN, USAID, Aleanca Gjinore për Zhvillim, ACPD, UNFPA etj.

Ndër faktorët ekonomik me ndikim më të madh listohen **vendndodhja gjeografike, konkurrenca nga njësitë e tjera territoriale**, cilësia e politikës ekonomike në nivel qendror dhe shkalla e papunësisë. Vendndodhja gjeografike dhe cilësia e politikës ekonomike në nivel qendror parashikohet sjellë ndikim pozitiv duke e lidhur me aspektin klimatik dhe politikat për mbështetje me fonde apo investime për zhvillim të mëtejshëm të zonës. Siç dhe evidentohet zhvillimi në Bashki është i lidhur ngushtë me situatën ekonomike në nivel kombëtar dhe rajonal. Në këto kushte, potencialisht parashikohet ndjeshmëri e lartë me ndikim negativ në nivel macroekonomik. Gjithashtu vëmendje i duhet dhënë faktorëve me ndikim mesatar si zhvillimi i industrisë së turizmit dhe kostove të punës, të cilat parashikohet se ndikojnë pozitivisht pasi në zonë evidentohet rritje e vazhdueshme të turizmit pasi ka potencial për zhvillimin e bizneseve në të katërta stinët dhe përthithje të emigrantëve për të investuar në vendlindje.

Faktorët me ndikim më të ulët vlersohen **gjendja e ekonomisë, dinamikat e rritjes ekonomike**, gjendja e financave publike, tendencat ekonomike të brendshme, niveli investimeve të huaja dhe niveli mesatar i të ardhurave por parashikohet se rritja e gjendjes ekonomike, përmirësimi i dinamikave ekonomike dhe tendencave ekonomike të brendshme ndikon pozitivisht në planin afatgjatë. Po ashtu, duhet theksuar se niveli i investive të huaja është i ulët ose i papërfillshëm por parashikohet ndikim pozitiv nëse në Bashkinë Pogradec do të ketë investime nga të huajt duke ndikuar në rritje e punësimit dhe cilësisë të shërbimeve por edhe do ndikojë në rritjen e konkurrencës.

Për shkak se zona urbane është e shtrirë pranë liqenit të Ohrit, **turizmi** është një nga faktorët prioritarë për rritjen ekonomike dhe investimet nga të huajt do i japin një tjetër dimension zhvillimit të turizmit. Po kështu, kryesisht emigrantët që kthehen kanë investuar në fushën e turizmit ku kanë hapur bare, restorante, bujtina etj. Shumë emigrantë të kthyer kanë hapur edhe aktivitete të tjera ekonomike në fushën e punimeve të hekurit, drurit, vetrat etj. të cilët kanë

marrë zanate jashtë vendit dhe operojnë si raste suksesi pas kthimit. Gjithashtu vërehet se emigrantët e kthyer i orientojnë fëmijët drejt arsimit profesional. Për nxitje dhe kualifikimin në arsimin profesional, Bashkia i mbështet me burse për të tërhequr studentë që të ndjekin arsimin profesional si saldatorë, elektrikistë, mekanikë, hidraulikë të kualifikuar etj., duke synuar të ndihmojnë edhe emigrantët që hapin biznese të punësojnë staf të kualifikuar. Por ka edhe emigrantë që eksperiencën e tyre në fushën e bujqësisë gjatë emigrimit e sjellin dhe investojnë në pronat e tyre ose blejnë tokë bujqësore.

Për sa i përket shërbimeve që vetë Bashkia ofron, struktura e vetme fizike në Bashkinë Pogradec që ofron shërbime për të huajt është zyra e informacionit, e cila jep informacion dhe orienton jo vetëm qytetarëve shqiptarë por edhe qytetarët e huaj që kanë vendbanim në Pogradec. Gjithashtu gjatë vitit 2024 janë planifikuar të ngrihen disa Info Point në disa pika kryesore të qytetit për turistat dhe vizitorët e huaj. Për më tepër është e rëndësishme të nënvizohet fakti se Bashkia Pogradec ka nevojë për një database për migrantët dhe diasporën.

Një numër i konsiderueshëm **faktorësh social-kulturorë vlersohen** me ndikim të madh për zhvillimin e Bashkisë Pogradec si roli i burrave dhe grave në shoqëri, emigracioni i puntorëve të kualifikuar, imigrimi i punëtorëve të pakualifikuar, zhvillimi i kapitalit njerëzor, lëvizshmëria e punëtorëve, tendencat e stilit të jetesës dhe plakja e popullsisë. Roli i burrave dhe grave në shoqëri, zhvillimi i kapitalit njerëzor, lëvizshmëria e puntorëve dhe tendencat e stilit të jetesës parashikohet se kanë ndikim pozitiv për barazinë gjinore, zhvillimin personal dhe profesional por edhe cilësinë e jetesës së komunitetit. Ndërsa emigracioni i puntorëve të kualifikuar, imigrimi i puntorëve të pakualifikuar dhe plakja e popullsisë vlersohet se do të kenë efekt negativ edhe në të ardhmen. Zhvillimi i organizatave Joqeveritare ndonse vlersohen se kanë ndikim të lartë, parashikohet se nuk do të përbënte ndryshim.

Për më tepër, faktorët me ndikim mesatar listohen **ndërgjegjësimi ekologjik dhe identiteti lokal** duke parashikuar efekt pozitiv, ndërsa pabarazitë sociale vlersohet se do të ndikojnë negativisht. Dy faktorë me ndikim të ulët por që duhet kushtuar vëmendje janë fondet për kujdesin shëndetësor dhe social si dhe shkalla e rritjes së popullsisë. Politikat për nxitjen e lindshmërisë dhe përmirësimin e kujdesit shëndetësor dhe social ndikojnë drejtpërdrejt pozitivisht në standardin e jetesës tek qytetarët.

Gjithashtu, Bashkia ka nevojë për **përditësim të informacionit** me shifra të sakta për emigrimin e puntorëve të kualifikuar, imigrimin e punëtorëve të pakualifikuar, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe lëvizshmërinë e punëtorëve për të adresuar nevojat dhe shqetësimet

kryesore jo vetëm për imigrantët por edhe për të huajt që jetojnë në këtë zonë në mënyrë që të mundësohet aksesimi në shërbime shëndetësore, arsim, apo tregun e punës. Në këtë Bashki nevojiten të dhëna për karakteristikat demografike kryesore të të huajve, imigrantëve që banojnë në njësitë administrative të kësaj Bashkie siç janë mosha, gjinia, origjina etnike, gjendja civile, arsimi, dhe përvoja e punës. Për rrjedhojë kjo Bashki nuk ka informacion as për strukturën familjare dhe marrëdhëniet sociale të të huajve dhe refugjatëve në komunitetin lokal.

Për sa i përket **mbështetjes sociale me ndihmë ekonomike** një nga sfidat lidhet me regjistrimin e saktë të personave që e marrin, pasi evidentohet se është fiktiv deklarimi në zyrën e punës për qytetarët që marrin ndihmë, ku kryefamiljari deklaron gjithë familjen si të papunë pavarësisht se antërrët meshkuj mund të ndodhen jashtë shtetit. Duke qenë se mund të jenë emigrantë sezonalë mund të vijnë çdo 3 muaj fizikisht të regjistrohen si të papunë dhe më pas largohen jashtë vendit në vendet fqinje. Po kështu, Bashkia Pogradec ka mungesë shërbimesh të dedikuara vetëm për migracionin dhe diasporën në fushat e arsimit, shëndetësisë, dhe zhvillimit ekonomik si dhe për integrimin social dhe kulturor të të huajve dhe imigrantëve në komunitetin lokal dhe në shoqërinë dhe duhet vepruar për të ofruar shërbime konkrete.

Për sa i përket **faktorëve teknologjikë**, fokusi primar është në zhvillimin e mediave sociale, pasi ka ndikim më të lartë dhe aksesohet lehtësisht. Për rrjedhim ka efekt pozitiv të menjëhershëm në shpërndarjen e informacionit dhe mundëson komunikimin e shpejtë dhe në kohë reale me migrantët dhe diasporën. Faktorët me efekt mesatar janë **zhvillimi i infrastrukturës**, automatizimi, aksesimi në teknologjinë moderne dhe zhvillimi i tele-work, ndikimi i të cilave parashikohet pozitiv por ka mungesë të theksuar të infrastrukturës dhe duhet përditësim me zhvillimet teknologjike. Faktorët me ndikim të ulët janë **fondet për projekte e kërkim shkencor dhe zhvillim**, zhvillimi i inovacionit si dhe zhvillimet e fundit teknologjike, për të cilat nevojitet vëmendje e shtuar për të ndjekur trendin në rritje në fushat e teknologjisë dhe inovacionit. Për këto faktorë parashikohet ndikim pozitiv por nuk ka investime dhe vëmendje për të ndjekur kërkesat teknologjike të kohës. Vlen të theksohet se në këtë zonë, teknologjia nuk ka mundur akoma të ndjekë zhvillimet më të fundit inovative si një burim lehtësues për zhvillim të mëtejshëm dhe është i nevojshëm fokusi për investime në aspektin teknologjik.

Si një zonë me potencial për zhvillim të mëtejshëm por dhe për të tërhequr kthimin në vendlindje të të larguarve shihet përfshirja e Diasporës dhe Migrantëve në vendimarrje dhe zhvillimin e politikave por aktualisht bëhet e mundur kryesisht nëpërmjet rrjetet sociale, duke

luajtur një rol të rëndësishëm në komunikim midis Bashkisë Pogradec dhe qytetarëve të diasporës. Ata shkruajnë në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec në Facebook dhe Instagram për problematikat dhe shqetësimet e tyre. Gjithashtu në procesin e hartimeve të Projekt Buxhetit të bashkisë dhe në eventet që publikohen në këto faqe ata shprehin sygjërimet e tyre.

Bashkia e Pogradecit ka organizuar disa forume për të lehtësuar komunikimin, bashkëpunimin dhe informimin, ku janë trajtuar çështje të problemeve sociale me komunitetin por edhe me institucione të ndryshme publike dhe organizata të shoqërisë civile. Janë organizuar shumë aktivitete informuese dhe fushata sensibilizuese por kanë qënë të kufizuara fizike pasi nuk ka patur akoma investime të nevojshme në teknologji dhe inovacioni.

QËLLIMI I PLANIT VENDOR

Qëllimi i Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën është të ndërtojë një infrastrukturë të përshtatshme për të menaxhuar me efikasitet dhe koordinuar çështjeve të migracionit dhe diasporës, duke i bërë ata faktorë të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik lokal. Bashkia Pogradec synon të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga vendndodhja e tyre, dhe punon për të nxitur përfshirjen dhe integrimin e tyre me të drejta të plota dhe të barabarta.

Misioni i Bashkisë është të përqendrohet në ofrimin e shërbimeve dhe lehtësirave në realitetin ekonomik-social për qytetarët. Për të arritur këtë, është e nevojshme një menaxhim i përmirësuar i burimeve vendore, një planifikim strategjik më i fuqishëm, forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale të administratës vendore, si dhe rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendim-marrëse. Në thelb, qeverisja e mirë dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë objektivat kryesore që pushteti vendor duhet të sigurojë për mirëqenien dhe përparimin e komunitetit lokal.

VIZIONI I PLANIT VENDOR TË MIGRACIONIT DHE DIASPORËS

Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, përfshirja e komunitetit të migracionit dhe diasporës në politikën socio-ekonomike dhe kulturore është thelbësore për ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe të barabartë. Vizioni ynë është të krijojmë një ambient ku çdo individ, pavarësisht prejardhjes së tij, ka mundësi të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi i vendit. Kjo përfshirje do të realizohet përmes politikave që inkurajojnë integrimin social, mbështesin iniciativat ekonomike dhe promovojnë trashëgiminë kulturore të komuniteteve të migracionit.

Ne do të zhvillojmë programe dhe iniciativa edukimi që nxisin mirëkuptimin dhe tolerancën, si dhe do të mbështesim sipërmarrësit e rinj nga diaspora për të investuar dhe për të krijuar vende pune në vendet e origjinës. Nëpërmjet partneriteteve të ndryshme do të krijojmë mundësi të reja për shkëmbimin kulturor dhe ekonomik. Qëllimi ynë është të ndihmojmë në forcimin e lidhjeve mes diasporës dhe vendit amë, duke bërë të mundur që ata të kontribuojnë aktivisht në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë, ku diversiteti festohet dhe respektohet, dhe ku çdo individ ndjen se zëri i tij ka rëndësi.



-Bashkia Pogradec Viti 2030 Poli

Zhvillimit-

“Zhvillimi i politikave socio-ekonomike-kulturore për përfshirjen e komunitetit të migracionit & diasporës”

OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR POGRADEC

Bashkia Pogradec synon të adresojë detyrat funksionale dhe ligjore për çështjet e diasporës dhe migracionit, në mënyrë që të arrijë objektivat e parashikuara në 3 fusha veprimi si më poshtë:

Tabela 2: Objektivat e Planit Vendor Pogradec

Fusha A. Organizimi dhe koordinimi institucional i diasporës dhe migracionit në nivel vendor.

Objektivat

A.1 Përmirësimi i organizimit dhe funksionimit të strukturave vendore në menaxhimin e diasporës dhe migracionit.

A.2 Trajnimi i vazhdueshëm dhe rritja e aftësive të specialistëve në njësitë vendore që trajtojnë çështjet e migracionit dhe diasporës.

A.3 Ndërtimi i partneriteteve afatgjata me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e rikthyer.

Fusha B. Shërbimet sociale publike me bazë komunitare.

Objektivat

B.1 Edukimi dhe informim i qëndrueshëm në lidhje me të drejtat dhe detyrimet ligjore.

B.2 Sigurimi i shërbimeve sociale për përfshirjen dhe rintegrimin e migrantëve të kthyer dhe komuniteteve të diasporës,

Fusha C. Zhvillimi dhe rritja e potencialit ekonomik të komunitetit local.

Objektivat

C.1 Njohja dhe shpërndarja e nevojave vendore të komunitetit me diasporën dhe migrantet.

C.2 Sigurimi i ndihmës për të përmirësuar investimet publike dhe private nga komuniteti diasporës dhe migrantët e kthyer

Për realizim sa më efektiv, fushat e veprimit kanalizojnë problematikat dhe proceset e tjera të veprimtarisë së bashkisë në objektiva, të cilat përkthehen në masa konkrete të matshme, të realizueshme dhe të monitorueshme.

FUSHA E VEPRIMIT A

Menaxhimi institucional i diasporës dhe migracionit përbën një komponent të rëndësishëm në politikën dhe zhvillimin lokal. Ai realizohet nëpërmjet veprimit në tre drejtime kryesore që përfshin organizimin funksional të strukturave vendore, rritjen e kapaciteteve profesionale të specialistëve në njësi vendore dhe ndërtimin e partneriteteve me komunitetet e diasporës, organizatat dhe të gjithë aktorët e përfshirë.

Organizimi funksional i strukturave përgjegjëse për menaxhimin e diasporës dhe migracionit, do të orientojë këtë proces në përputhje me nevojat e komunitetit dhe prioritetet kombëtare. Elementët kyç në këtë menaxhim përfshihen trajnimin e stafit dhe forcimin i njohurive të tyre në fushën e migracionit dhe diasporës, për t'i mundësuar atyre që të ofrojnë shërbime efektive dhe mbështetje për individët dhe familjet që janë pjesë e këtyre grupeve. Një element i rëndësishëm janë dhe komunikimet dhe raportimet e vazhdueshme me strukturat Qëndrore për migracionin dhe Diasporën, në mënyrë që të përfshihen në trajnime, takime të ndryshme, për të diskutuar nga afër vështirësit që këto struktura hasin në menaxhimin e rasteve dhe adresimin e nevojave që burojnë për këtë kategori si dhe monitorimin e implementimit të masave që kanë përgjegjësi. Për të siguruar një funksionim të mirë të strukturave, është e nevojshme hartimi dhe miratimi i përshkrimeve të punës dhe procedurave standarde të punës për trajtimin e rasteve të migrantëve dhe diasporës për personat përgjegjës në fushën e migracionit dhe diasporës. Këto përshkrime do të ndihmojnë në qartësimin e detyrave dhe përgjegjësi, duke garantuar një menaxhim më efikas të burimeve si dhe të sigurojnë një qasje të unifikuar dhe të sistematizuar. Prodhimi i materialeve informuese dhe promovuese për strukturën vendore të migracionit dhe diasporës, takime me përfaqësues të institucioneve publike, private dhe organizatave të shoqërisë civile, do të krijojnë mundësi për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni është gjithashtu i domosdoshëm. Këto materiale do të informojnë komunitetin për shërbimet dhe mbështetjen që ofrohen, duke kontribuar në ndarjen e informacionit të nevojshëm për individët e prekur. Për të inkurajuar angazhimin e komunitetit, është e nevojshme të organizohet një herë në vit një tryezë konsultuese me komunitetin e diasporës. Kjo do të krijojë një platformë për diskutim dhe ndarje mendimesh mbi çështjet që i prekin ata. Do të paraqiten project ide nga nga programme të ndryshme dhe nga vet diaspora, apo të sjella edhe nga OJQ për të siguruar mbështetje të qëndrueshme dhe të efektshme për ata që rikthehen nga migracioni

Tabela 3: Fusha e Veprimit A

Fusha e veprimit A.	Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit:	Periodha e zbatimit	Masat	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Rezultatet e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm
Organizimi dhe koordinimi institucional i diasporës dhe migracionit në nivel vendor.	Fuqizim i strukturave menaxheriale Institucionale për diasporën dhe migranët.						
Objektivi 1.1: Përmirësimi i organizimit dhe funksionimit të strukturave vendore në menaxhimin e diasporës dhe migracionit.	a) Hartimi i dhe miratimi i përkrahimit të punës për personat e përgjegjës në strukturën e migracionit dhe diasporës. b) Hartimi dhe miratimi i procedurave standarte të punës për trajtimin e rasteve të migrantëve dhe diasporës.	2025 - 2026			MB MCPV Organizata	Përkrahimi i punës i 1 akti aprouar Procedura të aprovuara i vendim	
	c) Prodhim i materialeve informuese dhe promovuese për Strukturën vendore të Migracionit dhe Diasporës	2025 - 2026			MB MCPV Organizata	Materiale të prodhuara	Deri në 5000 kopje
	d) Krijimi dhe pasurimi i bazës së të dhënave për organizatat e diasporës dhe emigrantët	2025 - 2028			AKD AKPA Organizata	Databazë e plotë	1-Vlera bazë 0 2-Masë nga 0
